

INFORMACIONE PËR
PRINDER

Lëndimet e lëkurës





Lëndimet e lëkurës

Të përgjithshme:

Plagët me prerje dhe ndrydhje (PPN-të) të fëmijët janë të shpeshta. Ato mund të shkaktohen nga mjetet për prerje, ndrydhjet apo qërimi i lëkurës. Caku i trajtimit të lëndimit është, pastrimi i lëndimit të pësuar, dezinfektimi dhe mbyllja më e mirë e mundur dhe ruajtja e funksionit të pjesës së prekur të lëkurës si dhe strukturave që gjenden nën të si dhe evitimi i infeksioneve.

Pore gati secili lëndim si pasojë të një shenjë (Përjashtim bëjnë lëndimet sipërfaqësore/gërvishtjet). Me këtë rast shumë faktorë luajnë një rol, të cilët edhe përmes trajtimeve mjekësore mund të ndikohen pak apo fare hiq. Mirëpo, nëse plaga është e hapur, e madhe, e ndotur apo strukturat nën të janë lënduara, atëherë është e domosdoshme, që kjo plagë të trajtohet nga një mjek.

Infeksioni

Mbi lëkurë për nga natyra gjenden bakteret. Me rast të një lëndimi këto baktere mund të futen në plagë

dhe të shkaktojnë infeksione.

Veçanërisht të rrezikuara nga infeksioni janë ato lëndime të cilat kanë ra në kontakt me pështymë të shtazëve apo edhe të njeriut, apo janë të ndotura shumë. Këto lëndime do të duhej gjithmonë të pastrohen shumë mirë.

Edhe përkundër dezinfektimit mund të vjen deri te infektimi i plagës, i cili normalisht paraqitet disa ditë pas aksidentit. Si shenjë e kësaj janë skuqjet lokale rreth vendit të lënduar, dhimbje dhe/apo të ënjtura përreth plagës. Në disa raste mund të shpërthen edhe qelbi nga plaga.

Vaksinimet

Bakteret e tetanosit gjenden gjithkund, futen përmes lëndimeve në trup, dhe te njerëzit e pa vaksinuar apo me vaksinim të mangët, mund të shkaktojnë tetanosin e plagëve, i cili shpesh është vdekjeprurës. Për këtë arsye është me rëndësi, që pas një lëndimi të kontrollohet mbrojtja e vaksinës dhe për çdo rast të bëhet ripërtëritja (me afat brenda 24orëve)

Pacientët të cilët nuk janë të vaksinuar apo vetëm pjesërisht (më pak se 4 vaksina tetanosi) të vaksinuar kundër tetanosit apo vaksinimi i fundit është bërë para më tepër se 5 vite, do të duheshin të vaksinohen sërish.

Plagët me gërvishtje:

Këto lëndime janë vetëm sipërfaqësore dhe kështu mjafton që vendi i prekur të dezinfektohet dhe gjithsesi të mbështjellët me fashë.

Plagët me prerje dhe ndrydhje (PPN):

PPN-të do të duhej të trajtohen nga ana e mjekut, kur ato:

- janë më të gjata se 1-2 cm
- janë thellë dhe/apo shumë të hapura
- janë të ndotura (ndyrësi, guralecë etj.)
- gjenden në fytyrë

Përndryshe mjafton një dezinfektim (si p.sh. Merfen, Betadine, Octenisept) si dhe mbështjellja me fashë apo vendosja e Steristrips.

Përkujdesja e mëtutjeshme

Po që se fëmija juaj u trajtua nga një mjek, atëherë juve ju informon mjeku i trajtimit mbi veprimet tuaja të mëtutjeshme. Sipas rregullave plaga në ditët e para nuk guxon të laget. Në rast të plagëve të ngjitura Steristripsët guxojnë të hiqen së pari pas 5 – 7 ditëve dhe fasha gjatë këtyre ditëve nuk do të duhej të laget. Te plagët e qepura apo të kllaposura, fijet gjegjësisht kllapat mund të hiqen pas 5 -14 ditëve (varësisht nga lokalizimi i plagës). Përgjatim bëjnë plagët të cilat janë qepur me fije resorbuese.

Heqja e fijeve me: _____

Kontrollimi me : _____

Pa Larje/Dush/Lagje
të fashës deri me : _____

Duhet të keni kujdes, që shenja e mbetur nga plaga gjatë së paku 6 muajve të ardhshëm konsekuent të mbrohet nga rrezatimi i diellit (Krem për mbrojtje nga dielli, mbulim me roba).

Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni për këshilla: +41 58 387 78 80



Kur do të duhej të shkoni te mjeku për shkak të lëndimit?

- Kur lëndimi është bërë nga kafshimi i një njeriu apo një shtaze.
- Kur plaga është shumë e hapur, e thellë dhe e ndotur.
- Kur plaga gjendet në fytyrë.
- Kur fëmija nuk ka më mbrojtje nga vaksina kundër tetanosit (Nëse deri tani nuk ka marrë apo ka marrë më pak se 4 herë vaksinë apo vaksina e fundit ripërtëritëse është bërë më parë se 5 vite).
- Kur rreth plagës pas disa ditëve paraqiten skuqje / të ënjtura dhe fëmija juaj fillon të ketë dhimbje dhe/apo ethe.
- Kur fëmija edhe disa ditë pas aksidentit ankohet në dhimbje të zonës së plagës.
- Kur ju edhe për shkak të një arsye tjetër brengoseni për fëmijën tuaj.

Ekipi i emergjencës, Spitali i fëmijëve Zürich Tetorë 2009



UNIVERSITÄTS-
**KINDERSPITAL
ZÜRICH**

 **Das Spital der
Eleonorenstiftung**

Universitäts-Kinderspital Zürich
Lenggstrasse 30
CH-8008 Zürich

www.kispi.uzh.ch
Telefon +41 44 249 49 49